



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

**V E N D I M**  
**K.P.P. 510/2018**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga :

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 02.08.2018 shqyrtoi ankesën me:

**Objekt:**

Shfuqizimin e vendimit të KVO-së lidhur me skualifikimin e operatorit ekonomik “Rama Graf” shpk në procedurën e prokurimit me Nr. REF-62022-04-11-2018, me objekt: “Botime, printime dhe materiale shtypshkrimi” – Marrëveshje Kuadër - me disa operatorë ekonomik ku te gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat deri më 31.12.2018, Loti V “Blerje shtypshkrimesh për Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, me fond limit 4.166.600 lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 07.05.2018, nga autoriteti kontraktor Ministria e Brendshme, Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara, Tiranë.

**Autoriteti kontraktor:**

Ministria e Brendshme, Tiranë  
Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara  
Sheshi “Skenderbej”, Nr.3, Tiranë.

**Ankimues**

“Rama Graf” sh.p.k  
Lagjia “5 Maji”, (Pranë Ekonomikut), Elbasan.

**Baza Ligjore:**

Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues; Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar; Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010, “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

**V Ë R E N:****I***Vlerësimi paraprak*

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën. 1, të nenit. 63, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

**Public Health Sector**

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Ligjin Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

**II***Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 12.04.2018 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit Nr. REF-62022-04-11-2018, me objekt: “Botime, printime dhe materiale shtypshkrimi” – Marrëveshje Kuadër - me disa operatorë ekonomik ku te gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat deri më 31.12.2018, Loti V “Blerje shtypshkrimesh për Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, me fond limit 4.166.600 lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 07.05.2018, nga autoriteti kontraktor Ministria e Brendshme, Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara, Tiranë.

II.2. Në datën 07.05.2018, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

Në këtë procedurë prokurimi kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë si më poshtë, të cilët referuar dokumentacionit të autoritetit kontraktor, kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH) për një vendroje në ditë, përkatësisht:

1. “Rama Graf” shpk	2.296.920	lekë	skualifikuar
2. “Shtëpia Botuese Morava” shpk	3.089.939	lekë	kualifikuar
3. “Adel Co” shpk	3.240.347	lekë	skualifikuar
4. “Interlogistic” shpk	3.357.700	lekë	skualifikuar
5. “Kristalina KH” shpk	3.370.000	lekë	kualifikuar
6. “Albtipografia” shpk	3.453.400	lekë	skualifikuar
7. “Albdesign” shpk	3.791.550	lekë	skualifikuar

II.3. Në datën 21.05.2018 operatori ekonomik “Rama Graf” shpk është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi për arsyen si më poshtë vijon:

*“Nuk plotëson kapacitetin teknik të përcaktuar në pikën 3, të seksionit 2.3, të kritereve të veçanta për kualifikim, të Shtojcës 9, të DST, pasi ofertuesi nuk ka vërtetuar disponimin e minimumi një makine shtypi me format 50X70 cm dhe minimumi një makinë qepëse, duke mos dorëzuar asnjë dokument që vërteton paisjen në pronësi apo me qira të tyre” Në lidhje me disponimin e minimum një makine shtypi me format 50x70 cm, ofertuesi ka paraqitur një fotokopje të deklaratës doganore, e cila nuk është në formën e kërkuar në DST, origjinale ose kopje e noterizuar.”.*

II.4. Në datën 21.05.2018 operatori ekonomik “Rama Graf” shpk ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor ku kundërshton vendimin e KVO-së lidhur me skualifikimin e ofertës së paraqitur prej tij, duke kërkuar kualifikimin e ofertës së tij, në mënyrë të përmbledhur me argumentet si më poshtë vijon:

*Pasi u njohëm me dokumentacionin për skualifikimin e firmës “Rama Graf” nga ana e autoritetit kontraktor më datë 21.05.2018, nëpërmjet mesazhit elektronik, ju sqarojmë se dokumentacioni i kërkuar të “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.5, “Kapacitetit teknik”, në pikën 3 të saj*

*operatori ekonomik ka paraqitur dokumentacionin e nevojshem për disponimin e makinerive si më poshtë :*

*-Makinë shtypi me format 50 x 70;*

*-Makinë qepse,*

*II-Përveç kësaj kemi ankesë në vlerësimin e KVO-së për Lotin V “Blerje shtypshkrime për Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza” për vlerën e ofertës tonë, e cila është 2.969.920 lekë pa TVSH dhe jo sipas vlerësimit të bërë që rezulton 2.296.920 lekë pa TVSH, e cila është vlerë e gabuar.*

*Përsa më sipër, kërkoj kualifikimin e firmës “Rama Graf” në vlerësimin e ofertave sipas KVO.*

*II.5. Në datën 28.05.2018, me shkresën nr. 525/1 prot, shoqëria “Rama Graf” shpk është vënë në dijeni në lidhje me trajtimin e ankesës së paraqitur prej tij nga autoriteti kontraktor me pretendimet si më poshtë:*

*Pranë Agjencisë së Blerjeve të Përqendruara, është depozituar ankesa protokolluar me tonën me nr. 525 prot, datë 21.05.2018, për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur” me objekt “Botime printime dhe materiale shtypshkrimi -Marrëveshje kuadër- me disa operatorë ekonomikë ndarë në Lote si më poshtë:*

*Loti I “Blerje dokumentacioni shkollor (regjistra, amza, dëftesa, çertifikata, pulla me helogram) për Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë” me fond limit 7,933,459 lekë pa TVSH;*

*Loti II “Libra dhe publikime profesionale për Kontrollin e Lartë të Shtetit” me fond limit 2,250,000 lekë pa TVSH;*

*Loti III “Blerje dokumentacioni për Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve” me fond limit 1,966,476.5 lekë pa TVSH;*

*Loti IV “Blerje dokumentacioni, shtypshkrime të ndryshme (kuti, dosje, formulare etj) dhe botimin e revistes Arkivore për Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave” me fond limit 3,458,334 lekë pa TVSH;*

*Loti V “Blerje shtypshkrimesh për Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza” me fond limit 4,166,600 lekë pa TVSH;*

*Loti VI “Shtypja e Fletores Zyrtare dhe kapakeve të botimeve tek të tjerët” me fond limit 2,290,989 lekë pa TVSH;*

*Loti VII “Shtypshkrime spitalore për spitalin Berat” me fond limit 1,041,506 lekë pa TVSH.*

*Në përgjigje të ankesës protokolluar pranë Agjencisë së Blerjeve të Përqendruara me nr. 525 prot, dt.21.05.2018, për tenderin me objekt “Botime printime dhe materiale shtypshkrimi -Marrëveshje kuadër- me disa operatorë ekonomikë ndarë në Lote si më poshtë:*

*Loti I “Blerje dokumentacioni shkollor (regjistra, amza, dëftesa, çertifikata, pulla me helogram) për Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë” me fond limit 7,933,459 lekë pa TVSH;*

Loti II “Libra dhe publikime profesionale për Kontrollin e Lartë të Shtetit” me fond limit 2,250,000 lekë pa TVSH;

Loti III “Blerje dokumentacioni për Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve” me fond limit 1,966,476.5 lekë pa TVSH;

Loti IV “Blerje dokumentacioni, shtypshkrime të ndryshme (kuti, dosje, formulare etj) dhe botimin e revistes Arkivore për Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave” me fond limit 3,458,334 lekë pa TVSH;

Loti V “Blerje shtypshkrimesh për Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, me fond limit 4,166,600 lekë pa TVSH;

Loti VI “Shtypja e Fletores Zyrtare dhe kapakeve të botimeve tek të tjerët” me fond limit 2,290,989 lekë pa TVSH;

Loti VII “Shtypshkrime spitalore për spitalin Berat” me fond limit 1,041,506 lekë pa TVSH, si dhe bazuar në nenin 63, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, në VKM Nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, neni 78, pika 5, në të cilin theksohet: “Gjatë procedurës së prokurimit, ankesat kundër vendimeve të autoritetit kontraktor, duhet të dorëzohen fillimisht pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga dita e nesërme e punës, nga data kur ankimesi është vënë në dijeni ose duhet të ishte vënë në dijeni për këtë shkelje të ligjit”.

Komisioni për Shqyrtimin e Ankesës pasi shqyrtoi të gjithë dokumentat e vëna në dispozicion si: ankesa e ardhur për këtë procedurë, DST, dokumentat e hedhura në sistem nga operatori., etj i ka komunikuar Drejtorit të Përgjithshëm vendimin si më poshtë:

Pas shqyrtimit të saj u konstatua se shoqëria “Rama Graf”, ka ankimuar s'kualifikimin pasi:

1- Vlerëson të padrejtë skualifikimin për arsyen: “Nuk plotëson kapacitetin teknik të përcaktuar në pikën 3, të seksionit 2.3, të kriterëve të veçanta për kualifikim, të Shtojcës 9, të DST, pasi ofertuesi nuk ka vërtetuar disponimin e minimumi një makine shtypi me format 50X70 cm dhe minimumi një makinë qepëse, duke mos dorëzuar asnjë dokument që vërteton paisjen në pronësi apo me qira të tyre.

Kriteret e veçanta të kualifikimit vendosen nga autoriteti kontraktor për të patur një panoramë të përgjithshme të aftësive teknike, ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimeve, të cilat ndikojnë në mënyrë të drejtëpërdrejtë në realizimin me sukses të kontratave.

Operatori ka paraqitur ankesë, pasi pretendon se dokumentacioni i kërkuar të “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, pika 2.5, “Kapaciteti Teknik”, në pikën 3 të saj, operatori ekonomik ka paraqitur dokumentacionin e nevojshëm për disponimin e makinerive, si më poshtë:

-Makinë shtypi me format 50x70:

-Makinë qepëse, ku për të dyja është paraqitur fatura e çdoganimit, që përcaktohet qartë lloji i tyre.

*Pas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave vendosi si të drejte skualifikimin e operatorit, pasi nuk vërtetohet pronësia e makinës së shtypit me format 50x70 dhe makinës qepëse nga subjekti “RAMA GRAF” shpk, me NIPT K42701205E. Nga kqyrja e faturës së zhdoganimit nuk rezulton që të jetë paraqitur në formën e kërkuar, nga skanimi i saj nuk dallohen vulat dhe firmat origjinale të autoriteteve doganore ose të ketë kopje të njëjsuar me origjinalin nga noteri publik. Gjithashtu në faturën e zhdoganimit ka një mospërputhje midis NIPT-it të operatorit dhe atij për llogari të të cilit është kryer zhdoganimi.*

*Sa më sipër, KSHA ka gjykuar dhe vendosur se ky dokument ka pasaktësi në përmbajtje dhe nuk është paraqitur në formën e kërkuar, sipas pikës 3, të “Kapacitetit Teknik”, në “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit” (fq 55 e DST), duke përbërë shkak të arsyeshem dhe të bazuar për skualifikimin e operatorit “Rama Graf” shpk.*

*Sipas pikës 3, të nenit 53, të Ligjit Nr.9643, dt.20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, në të cilin citohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4, të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54, të këtij ligji “.*

*2- Operatori ka paraqitur ankesë në lidhje me vlerësimin e KVO-së për Lotin V “Blerje shtypshkrimesh për Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, me fond limit 4,166,600 lekë pa TVSH, për vlerën e ofertës, e cila është 2,969,920 0 lekë pa TVSH dhe jo sipas vlerësimit të bërë nga KVO, e cila është 2,296,920 lekë pa TVSH.*

*Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave ka vendosur të pranojë pretendimin e operatorit, pasi nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar për Lotin V, vlera e ofertës të paraqitur nga operatori është 2,969,920 lekë pa TVSH. Në bazë të nenit 63, të Ligjit Nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 78, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik “; i ndryshuar, vendos rikthimin në KVO për korrigjimin dhe saktësimin e vlerës së ofruar nga subjekti “Rama Graf” shpk, duke theksuar se ky korrigjim nuk përbën shkak për kualifikimin e operatorit ekonomik, sa kohë mbetet i skualifikuar sipas pikës 1, të këtij vendimi.*

II.6 Në datën 05.06.2018, autoriteti kontraktor ka bërë rivlerësimin e procedurës së prokurimit në bazë të ankesës së operatorit ekonomik “Rama Graf” shpk, me renditjen si më poshtë:

1. “Rama Graf” shpk	2.969.920 lekë	skualifikuar
2. “Shtëpia Botuese Morava” shpk	3.089.939 lekë	kualifikuar
3. “Adel Co” shpk	3.240.347 lekë	skualifikuar

4. "Interlogistic" shpk	3.357.700	lekë	skualifikuar
5. "Kristalina KH" shpk	3.370.000	lekë	kualifikuar
6. "Albtipografia" shpk	3.453.400	lekë	skualifikuar
7. "Albdesign" shpk	3.791.550	lekë	skualifikuar

Gjithashtu arsyeja e skualifikimit të operatorit ekonomik "Rama Graf" shpk, pas procesit të rivlerësimit është e njëjtë me arsyen e skualifikimit në njoftimin e datës 21.05.2018, si më poshtë:

*"Nuk plotëson kapacitetin teknik të përcaktuar në pikën 3, të seksionit 2.3 të kriterëve të vecanta për kualifikim, të Shtojcës 9 të DST, pasi ofertuesi nuk ka vërtetuar pasjen e minimumi një makinë shtypi me format 50X70 cm dhe minimumi një makinë qepëse, duke mos dorëzuar asnjë dokument që vërteton pasjen në pronësi apo me qira të tyre".*

II.7. Në datën 04.06.2018, pala ankimuese operatori ekonomik "Rama Graf" shpk ka dorëzuar ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duke zvogëluar objektin e ankesës, duke parashtruar pretendimin si më poshtë:

*Pasi u njohëm me dokumentacionin për skualifikimin e firmës "Rama Graf" nga ana e autoritetit kontraktor, pretendojmë se dokumentacioni i kërkuar të "Kriteret e vecanta të kualifikimit" pika 2.5, "Kapacitetit teknik", në pikën 3, të saj operatori ekonomik ka paraqitur dokumentacionin e nevojshëm për disponimin e makinerive si më poshtë:*

-Makinë shtypi me format 50 x 70;

-Makinë qepse,

*Për të dyja është paraqitur fatura e çdoganimit, që përcakton gamën dhe llojin e tyre.*

*Për makinën e celefonimit kemi paraqitur faturën e blerjes, ku përcaktohet lloji i saj.*

*Përsa më sipër, kërkoj kualifikimin e firmës "Rama Graf" shpk, në vlerësimin e ofertave sipas KVO.*

II.8. Me shkresën me nr. 525/2 prot, datë 14.06.2018, protokolluar me tonën me nr. prot. 1054/2 datë 19.06.2018, me objekt "Dërgim dokumentacioni për Lotin V "Blerje shtypshkrimesh për Qendrën Spitalore Universitare "Nënë Tereza" është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni dhe dokumentacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit dhe trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

### III

#### Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumenteve të dërguara nga autoriteti kontraktor,

#### Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Rama Graf” shpk, mbi kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së paraqitur prej tij me arsyen se: *“Pasi u njohëm me dokumentacionin per skualifikimin e firmës “Rama Graf” nga ana e autoritetit kontraktor, pretendojmë se dokumentacioni i kërkuar te “Kriteret e vecanta të kualifikimit”, pika 2.5, “Kapacitetit teknik” në pikën 3, të saj operatori ekonomik ka paraqitur dokumentacionin e nevojshem për disponimin e makinerive si më poshtë:*

*-Makinë shtypi me format 50 x 70;*

*-Makinë qepse,*

*Për të dyja është paraqitur fatura e çdoganimit, që përcakton gamën dhe llojin e tyre.*

*Për makinën e celefonimit kemi paraqitur faturën e blerjes, ku përcaktohet lloji i saj.*

*Përsa më sipër, kërkoj kualifikimin e firmës “Rama Graf” shpk, në vlerësimin e ofertave sipas KVO”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:*

III.1.1. Në dokumentat e tenderit, Shtojca 9 Lotin V *“Blerje shtypshkrimesh për Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, “Kapaciteti teknik”, pika 3, autoriteti kontraktor ka parashikuar se: “Operatori ekonomik duhet të ketë:*

- *Minimumi një makinë shtypi me format 50X70,*
- *Minimumi një makinë qepëse,*
- *Minimumi një makinë celefoni*

*Për të vertetuar këtë pike operatori ofertues duhet të paraqesë:*

- ✓ *Në rast se makineritë janë në pronësi të tij, faturën e blerjes ku të përcaktohet qartë lloji i makinerisë ose faturën e zhdoganimit e të makinerisë ku të përcaktohet qartë lloji i saj.*
- ✓ *Në rast se makineritë janë marrë me qira të paraqitet akti i qiramarrjës shoqëruar me faturën e blerjes ku të përcaktohet qartë lloji i makinerisë ose faturën e zhdoganimit e të makinerisë ku të përcaktohet qartë lloji i saj të qiradhënësit”.*

III.1.2. Për përmbushje e kriterit të sipërpërmendur ofertuesi “Rama Graf” shpk ka dorëzuar në SPE dokumentacionin e si më poshtë vijon:

*Deklaratë datë 07.05.2018, të administratorit të shoqërisë “Rama Graf” shpk, ku citohet se: “Sipas kërkesës së dokumentave të tenderit firma “Rama Graf” disponon të gjitha makineritë e*



*nevojshme. Bashkangjitur ju dërgojmë çdoganimin dhe faturën e blerjes të makinerive mbas kërkesës suaj”.*

*Deklaratë doganore zhdoganime, IMP.1, nr.24/4, datë 29.07.1997, të kryer në Degën Doganore Elbasan, nga ana e subjektit importues “Rama Graf” Elbasan, për makineritë në vijim: Makinë shtypi offseit 50x70; Makinë zhvillimi lastre dhe Makinë qepëse.*

*Faturë tatimore Nr i serisë: 41213693, datë 03.05.2018, me shitës shoqërinë “Dita Print” shpk dhe blerës shoqëria “Rama Graf” shpk, për blerjen e një copë makinë celefonimi “Foliant 520T”.*

III.1.3. Në nenin 46, pika 1 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese”.*

III.1.4. Në nenin 53, pika 3 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”.*

III.1.5. Në nenin.66, pika.3, të VKM Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, përcaktohet se: *“Pas mbylljes së seancës publike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit”.*

III.1.6. Në Manualin nr.1, datë 26.01.2018 “Për rregjistrimin e operatorëve ekonomikë dhe dorëzimin e ofertave në sistemin e prokurimit elektronik”, hartuar nga Agjencia e Prokurimit Publik, në faqen 17 e tij, paragrafi i parë thuhet se: *“Dokumentat e skanuar duhet të jenë origjinal ose kopje e noterizuar, versioni i skanuar i këtyre dokumentave pasi hidhet ne sistemin e prokurimit elektronik, për një procedurë konkrete është i barasvlefshëm me dokumentin origjinal ose kopjen e noterizuar”.*

III.1.7. Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur në procedurë lidhur me vërtetimin e disponimit të makinërive të kërkuara në dokumentat e tenderit, Komisioni konstatoi se ofertuesi ka paraqitur faturë tatimore blerje dhe deklaratë zhdoganimi për makineritë e kërkuara, ku përcaktohet dhe llojin e tyre si në vijim: *makinë shtypi offset 50x70, makinë zhvillimi lastre makinë qepëse dhe makinë celefonimi.*

III.1.8. Referuar kriterit të kualifikimit ku rezulton se autoriteti kontraktor ka kërkuar nga operatorët ekonomikë të provojnë se disponojnë pajisje teknike të nevojshme për realizimin e kontratës, duke paraqitur faturën e blerjes ku të përcaktohet qartë lloji i makinerisë ose faturën e zhdoganimit e të makinerisë ku të përcaktohet qartë lloji i saj ose në rast se makineritë janë marrë me qira të paraqitet akti i qiramarrjës shoqëruar me faturën e blerjes ku të përcaktohet qartë lloji i makinerisë ose faturën e zhdoganimit e të makinerisë ku të përcaktohet qartë lloji i saj të qiradhënësit, KPP gjykon se operatori ekonomik ankimues me dokumentacionin e paraqitur plotëson kriteret e kualifikimit të sipërcituara. Konkretisht operatori ekonomik “Rama Graf” shpk ka dorëzuar faturën tatimore të blerjes dhe deklaratën doganore me anë të së cilave dëshmon se disponon pajisjet teknike të kërkuara të nevojshme për realizimin e kontratës.

Pretendimi i ankimuesit qëndron.

III.2. Gjithashtu KPP konstaton se në kthim përgjigjen drejtuar ankimuesit KSHA ka shtuar arsyet e skualifikimit për operatorin ekonomik ankimues të cilat nuk i janë komunikuar në momentin e vlerësimit përfundimtar të ofertave nga KVO. Konkretisht është shtuar arsyeja e skualifikimit si në vijim: *“Gjithashtu në faturën e zhdoganimit ka një mospërputhje midis NIPT-it të operatorit dhe atij për llogari të të cilit është kryer zhdoganimi.”*

III.2.1. Në nenin 54 pika 3 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar parashikohet se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji”*. Në nenin 66 pika 3 të Vendimit nr.914 të Këshillit të Ministrave datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, parashikohet se *“Pas mbylljes së seancës publike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Nëse është e nevojshme, komisioni i vlerësimit të ofertave kërkon sqarime nga ofertuesit, të cilat duhet të jenë me shkrim ose të reflektuara në procesverbal.”* Ndërkohë në nenin 67 të Vendimit nr.914 të Këshillit të Ministrave datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, parashikohet se: *“Në bazë të ofertave të pranuar, komisioni i vlerësimit të ofertave harton klasifikimin përfundimtar, i cili u komunikohet ofertuesve në kohën e përcaktuar në këto rregulla”*. Në nenin 63, pika 1, 2, 5 dhe 6, të ligjit nr.9643, dt.20.11.2006 “Për prokurimin publik” është parashikuar: *“Çdo person që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin.”* *“Ankesa i paraqitet, së pari, me shkrim, autoritetit kontraktor në fjalë brenda 7 ditëve nga dita e nesërme e punës kur ankimuesi është vënë në dijeni ose duhet të ishte vënë në dijeni për shkeljen e pretenduar, sipas këtij ligji.”* *“Autoriteti kontraktor shqyrton ankesën dhe merr një vendim të arsyetuar brenda 7 ditëve pas marrjes së ankesës, të cilin duhet*

*t'ia njoftojë ankuesit jo më vonë se në ditën vijuese të punës”. Ndërsa në pikën 6 të kësaj dispozite është përcaktuar se: “Nëse autoriteti kontraktor nuk shqyrton ankesën brenda afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose e refuzon atë, ankimesi mund të paraqesë një ankesë me shkrim në Komisionin e Prokurimit Publik brenda 10 ditëve nga dita e nesërme e punës, pas përfundimit të afatit kohor, të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose, në rast se ankesa nuk pranohet nga autoriteti kontraktor, që nga dita kur ankuesi është njoftuar nga autoriteti kontraktor. Një kopje me shkrim i dërgohet detyrimisht edhe autoritetit kontraktor.”*

III.2.2. Në kreun X “Shqyrtimi i Ankesave”, neni 78, pika 6 i Vendimit nr.914 të Këshillit të Ministrave datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar parashikohet se “Për shqyrtimin e ankesave, autoriteti kontraktor ndjek hapat e mëposhtëm: a) Titullari i autoritetit kontraktor ia ngarkon çështjen një komisioni të përbërë nga 3 (tre) persona, për të shqyrtuar ankesën dhe për të dhënë një vendim. Përjashtimisht, në rast të mungesës së personelit, titullari i autoritetit kontraktor ia ngarkon çështjen për shqyrtim 1 (një) zyrtari të vetëm. Komisioni/zyrtari i ngarkuar është përgjegjës për vendimin e dhënë në përfundim të shqyrtimit të ankesës. Anëtarët e komisionit/zyrtari i ngarkuar nuk duhet të kenë marrë pjesë në marrjen e vendimit, për të cilin është paraqitur ankesa. Në rast se ankimi lidhet me dokumentet e tenderit, titullari i autoritetit kontraktor mund t’ia ngarkojë shqyrtimin e ankesës komisionit të vlerësimit të ofertave.” Në nenin 78, pika 6 gërma “ç” të Vendimit Nr.914 të Këshillit të Ministrave dt.29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar parashikohet se: [...]Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, komisioni/zyrtari i ngarkuar për shqyrtimin e saj mund të marrë vendim për refuzimin ose pranimin e ankesës, i cili i komunikohet menjëherë titullarit të autoritetit kontraktor. Në rastin kur ankesa është pranuar, titullari i autoritetit kontraktor i adreson vendimin për zbatim komisionit të vlerësimit të ofertave.

III.2.3. Komisioni i Prokurimit Publik thekson faktin se përcaktimi i procedurave dhe afateve të caktuara procedurale në LLP dhe Rregullat e Prokurimit Publik, duke filluar nga afati për përgatitjen e ofertës, afati i shqyrtimit të ofertave, afati i ankimimit etj, përfaqësojnë garanci juridike për palët e interesuara. Parimi i ligjshmërisë është ndër parimet kryesore të veprimtarisë së organeve të administratës publike, (Neni 4 i K.pr. Administrative). Gjithashtu, ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurave të prokurimit, parashikuar nga *lex specialis* LPP, në neni 2 të tij janë ato të mos diskriminimit, transparencës dhe barazisë. Tërësia e elementëve të mësipërm lidhet ngushtësisht me elementë të ligjshmërisë së vendimeve të organeve të administratës publike. Në interpretim interpretim sistematik (domethënjen e drejtë të normës juridike duke e vënë në lidhmëri me normat e tjera brenda sistemit juridik), Komisioni i Prokurimit gjykon se ligjvënësi ka ndarë qartësisht dy momentet procedurale atë të vlerësimit të ofertave nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave dhe momentin e dytë të garancisë procedurale të mbrojtjes së interesave të ligjshme të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit, atë të ankimit administrativ pranë autoritetit kontraktor ( rishikimin e

vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave) nga vetë autoriteti kontraktor por nga një trupë e re, e cila nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesave me komisionin e vlerësimit të ofertave, shqyrtimin e ankesave nga K.Sh. A ( Komisioni i Shqyrtimit të Ofertave). Normativa e mësipërme, parashikuar nga neni 63 i ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar, rregullon të drejtën e personave të interesuar në një procedurë prokurimi për të paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe më pas pranë Komisionit të Prokurimit Publik në kuadrin e rishikimit administrativ të kësaj procedure, e thënë ndryshe, legjitimitimin për të vënë në lëvizje dhe investimin e autoritetit kontraktor për rishikimin e vendimit të KVO-së. Në rastin konkret KPP konstaton se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave gjatë shqyrtimit administrativ të ankesës ka vendosur mospranimin e ankesës së operatorit ekonomik “Rama Graf” shpk si dhe ka shtuar arsye të reja skualifikimi në tejkalim të kompetencave që parashikon ligji.

III.2.4. Sa më sipër Komisioni gjykon se arsyet e reja të skualifikimit dhënë nga Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, në tejkalim të kompetencave që u jep shprehimisht neni 78 i VKM nr.914 datë 29.12.2014 nuk sjellin asnjë pasojë mbi operatorin ekonomik ankimes e si të tilla nuk merren në shqyrtim nga KPP.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenit 28 të VKM-së nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

**Vendos:**

1. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Rama Graf” shpk për procedurën e prokurimit Nr. REF-62022-04-11-2018, me objekt: “Botime, printime dhe materiale shtypshkrimi” – Marrëveshje Kuadër - me disa operatorë ekonomik ku te gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat deri më 31.12.2018, Loti V “Blerje shtypshkrimesh për Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, me fond limit 4.166.600 lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 07.05.2018, nga autoriteti kontraktor Ministria e Brendshme, Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara, Tiranë.
2. Të anulojë vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “Rama Graf” shpk dhe të korrigjojë shkeljet, duke e kualifikuar këtë operator ekonomik.
3. Autoriteti kontraktor brenda 10 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.

4. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “*Rama Graf*” shpk.

5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Nr. 1054 Protokolli;**

**Datë 04.06.2018**

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Nënkryetar  
Enkeleda Bega**

**Anëtar  
Wilma Zhupaj**

**Anëtar  
Lindita Skeja**

**Anëtar  
Merita Zeqaj**



